



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.03.2019, miratoi këtë

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim dita e shtune e javës së fundit të çdo muaji, caktohet ditë në të cilën Komuna e Suharekës do të merr aktivitet për pastrimin e ambientit në tërë territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 2

Pastrimi i ambientit do të bëhet në mënyrë vullnetare nga i gjithë komuniteti i Komunës tonë pa dallim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shërbime publike, emergjencë dhe mjedis e Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 06-21006

Me datë 29.03.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI